

## NË KËTË NUMËR:

<i>Shumë studentë të interesuar për praktikë në Gjermani</i>	2
<i>Hulumtime për të rinjtë</i>	3
<i>Në Kolegjin "Pjetër Budi" përfundoi "Muaji i të drejtave të njeriut"</i>	4
<i>Publikohet broshura me esetë më të mira</i>	5
<i>Në "Pjetër Budi" u prezantuan projektet e ERASMUS-it</i>	6
<i>Trajnim për stafin akademik</i>	7
<i>Studentët në vizitë turistike në Maqedoni</i>	10
<i>dhe të tjera...</i>	

## Shumë studentë të interesuar për praktikë në Gjermani

Është mbajtur procesi i intervistimit dhe testimit të studentëve kandidatë për pjesëmarrje në praktikën tremujore në kompanitë gjermane, me të cilat Kolegji "Pjetër Budi" ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi. Një numër i madh aplikantësh kanë shprehur interesim për të kryer praktikën në Gjermani. Të gjithë janë intervistuar nga komisioni profesional, si dhe iu janë nënshtruar testeve me shkrim e me gojë, në gjuhët gjermane e angleze.

Studentët do të kenë mundësi që në Gjermani të kryejnë praktikën profesionale tremujore falë marrëveshjes së arritur ndërmjet "Pjetër Budit" dhe Fakultetit të Makinerisë të Universitetit të Offenburgut, si dhe kompanive Ma-Tax Consulting GmbH, BEO GmbH e FAMA Sh.P.K. marrëveshja u nënshkrua të martën në Prishtinë.

Marrëveshja përfshin edhe fusha të tjera të bashkëpunimit, si shkëmbim të stafit dhe përvojave shkencore profesionale nga fusha e doganës dhe shpedicionit, bashkëpunim në projektet të përbashkëta shkencore profesionale, bashkëpunimi në sferën e trajnimit dhe edukimit të stafit të Kolegjit "Pjetër Budi", si dhe realizim të vizitave studimore në Gjermani dhe anasjelltas.





## Hulumtime për të rinjtë



Pas përfundimit të semestrit dimëror, disa grupe studentësh të Kolegjit “Pjetër Budi” janë fokusuar në hulumtimet në mesin e të rinjve, duke synuar të evidentojnë çështje që i preokupojnë ata dhe më pas, të propozojnë zgjidhje për problemet me të cilat ballafaqohen.

Hulumtimet realizohen në kuadër të punës shkencore dhe praktike të studentëve, me të cilën karakterizohen studimet në “Pjetër Budi”.

## Studentët prezantuan hulumtimet

Një numër hulumtimesh të realizuara nga studentët gjatë semestrit dimëror të vitit akademik 2013/2014 janë prezantuar në Kolegjin “Pjetër Budi”. Në hulumtime janë trajtuar tema të ndryshme dhe ato janë realizuar në terren nga studentët të ndarë në grupe. Disa nga temat e prezantuara ishin: “Aspekti social-ekonomik i duhanpirjes në Kosovë”, “Kënaqshmëria me shërbimet e operatorëve mobilë”, “Komunikimi me institucionet publike”, “Respektimi i Ligjit të Punës në Kosovë”, “Lexueshmëria e gazetave në Kosovë” etj.




## Në Kolegjin “Pjetër Budi” përfundoi “Muaji i të drejtave të njeriut”

Me prezantimin e eseve të studentëve, të realizuara në temën e të drejtave të njeriut, më 10 janar 2014 në Kolegjin “Pjetër Budi” ka përfunduar “Muaji i të drejtave të njeriut”, një aktivitet që ka filluar më 10 dhjetor të vitit të kaluar, në Ditën Ndërkombëtare të të Drejtave të Njeriut.

Studentët në esetë e tyre kanë trajtuar tema tëndryshme që kanë të bëjnë me shkeljen e të drejtave të njeriut në Kosovë dhe më gjerë.

“Muaji i të drejtave të njeriut” në “Pjetër Budi” më 10 dhjetor nisi me ligjëratën e Adem Demaçit dhe shfaqjen e filmit dokumentar “Dear Mandela”, përkatësisht me debatin rreth respektimit të të drejtave të njeriut, për të vazhduar me shfaqjen e filmit dokumentar “Tri ditë para fillimit” të autorit Arsim Lani.

Në kuadër të aktiviteteve të këtj muaji ishte edhe bashkëbisedimi me studentët i Avokatit të Popullit, Sami Kurteshi dhe më pas pjesëmarrja e studentëve në Festivalin Ndërkombëtar të Filmit Dokumentar për të Drejtat e Njeriut “Një Botë”, i cili u mbajt në Kolegjin “Pjetër Budi”.





## Publikohet broshura me esetë më të mira

Esetë më të mira të studentëve në temën e të drejtave të njeriut janë përmbledhur në një broshurë, e cila është publikuar nga Kolegji "Pjetër Budi". Në ese janë trajtuar tema të ndryshme, si të drejtat e fëmijëve, të drejtat e femrave, e drejta për t'u edukuar, shkelja e të drejtave të njeriut në Kosovë dhe më gjerë etj.

Esetë e përmbledhura në broshurë janë shkruar nga studentët e vitit të parë të drejtimit Doganë dhe Shpedicion, në kuadër të aktiviteteve që janë organizuar me rastin e "Muajit të të drejtave të njeriut", e që në këtë institucion është mbajtur nga data 10 dhjetor 2013 deri më 10 janar 2014.



## Në “Pjetër Budi” u prezantuan projektet e ERASMUS-it

Kolegjin “Pjetër Budi” e ka vizituar koordinatori i Zyrës së Tempusit në Kosovë, Kimete Canaj. Për studentët dhe stafin ajo mbajti një prezantim të projektit ERASMUS, pjesë e programit të Bashkimit Evropian, me ç’rast shpjegoi të gjitha mundësitë për pjesëmarrje në projektet e këtij programi.



Canaj inkurajoi stafin akademik e administrativ, si dhe studentët e Kolegjit “Pjetër Budi” që të aplikojnë për të përfituar nga projektet e shumta që ofron programi.





## Trajnim për stafin akademik

Në vazhden e trajnimeve të ndryshme, që organizohen nga Kolegji “Pjetër Budi” është organizuar edhe trajnimi për sistemet dhe programet elektronike, për stafin akademik të kolegjit, me rastin e avancimeve në digjitalizimin e përgjithshëm të institucioniut. Trajnimi kishte për qëllim që i gjithë stafi akademik i “Pjetër Budit” të aftësohet në nivelin më të lartë për përdorimin e sistemeve dhe programeve elektronike që kanë të bëjnë me punën e tyre të përditshme me studentët.



Kolegji “Pjetër Budi” mban primatin në Kosovë dhe më gjerë sa i përket digjitalizimit të procesit mësimor akademik.



## Studentë të “Pjetër Budi” vizituan FSK-në në Ferizaj

Studentë të Kolegjit “Pjetër Budi” kanë vizituar Komandën e Doktrinës dhe Stërvitjes në Kazermën “Skënderbeu” në Ferizaj. Vizita kishte për qëllim njohjen e studentëve me menaxhimin dhe aktivitetet e kësaj qendre edukimi për trupat e FSK-së, si dhe mënyrën e metodat e mësimin, trajnimit etj.

Profesori Ibish Mazreku vlerësoi lart pritjen e bërë studentëve nga shefi i shtabit të Komandës..., kolonel Fadil Hadërgjonaj, i cili i ka shoqëruar ata në të gjitha qendrat e brendshme në kuadër të Komandës..., ku zhvilloheshin aktivitete të ndryshme me kadetë nëpër klasa.

“U njoftuam edhe me jetën e brendshme të ushtarëve, oficerëve dhe nënoficerëve. Disiplina, organizimi i brendshëm, hierarkia, rregulli dhe pastërtia lënë përshtypjen e një institucioni bashkëkohor dhe me standarde bashkëkohore në shërbim të qytetarëve dhe vendit”, tha profesor Mazreku.


Gjatë vizitës është diskutuar edhe për mundësinë dhe rëndësinë e bashkëpunimit dhe këmbimit të përvoja nga të dyja palët, me qëllimin të jenë në shërbim të qytetarëve dhe vendit.







## Sa lexojmë? 58 % thonë tre libra në vit!



Interneti dhe zhvillimet e hovshme teknologjike kanë bërë që librat të mos lexohen si më parë. Kështu, sipas një sondazhi të realizuar në faqen e internetit të Kolegjit “Pjetër Budi”, 58 për qind e të anketuarve lexojnë më shumë se tre libra gjatë një viti, ndërkaq 42 për qind më pak se tre libra.

Sipas një ankete botërore të realizuar vite më parë, hindusët ishin lexuesit më të mëdhenj në botë, duke lexuar mesatarisht 10.7 orë në javë. Kina, Filipinet dhe Rusia zinin vendin e dytë, tretë dhe të katërt me respektivisht 8, 7.6 dhe 7.1 orë në javë, mesatarisht. Britanikët dhe amerikanët kishin gati gjysmën e orëve të Indisë me respektivisht 4.1 dhe 3.1 orë në javë.

Një sondazh i BBC-së në shqip, i realizuar vite më parë me shqiptarë moshash të ndryshme tregonte se arsye e mosleximit të mjaftueshëm ishin aktivitetet tjera me të cilat humbej koha. Po ashtu, shumë të anketuar thoshin se nuk kanë kohë për lexim, ose lexojnë vetëm libra që i kanë të detyrueshme. Megjithëse kishte edhe të atillë që si shkaqe kryesore të rënies së interesimit ndaj librit përmendnin nivelin e ulët kulturor dhe rolin joedukues të mediave.

## Studentët në vizitë turistike në Maqedoni



Studentë dhe një pjesë e stafit të Kolegjit "Pjetër Budi" kanë realizuar një vizitë turistike treditore në qendrën e skijimit Bregu i Diellit, afër Tetovës në Maqedoni.

Me këtë rast u shkëmbyen edhe përvoja dhe bashkëbisedime me profesorët, në një ambient relaksues. Vizita është organizuar nga Organizata Studentore në kuadër të aktiviteteve të shumta jashtakademike që organizohen nga kolegji gjatë gjithë vitit.







***Shihemi në semestrin e ri!***

*Në Kolegjin "Pjetër Budi" ka përfunduar semestri dimëror i vitit akademik 2013/2014.  
Studentët do t'iu kthehen ligjëratave pas një muaji, në semestrin veror.*